

Bota SIGAL

NEWSLETTER për vitin 2024



Avni
PONARI

Gjithmonë një hap
përpara.

PONARI PROPOZON
ZGJIDHJEN PËR
PENSIONET:
SIGURIM I
DETYRUESHËM ME
DY PJESË

SIGURIMET - NJË
SHTYLLË
THEMELORE E
ZHVILLIMIT
EKONOMIK

SIGAL, MBETET
KOMPANIA MË E
MADHE SHQIPTARE
E SIGURIMEVE NË
EVROPËN
JUGLINDORE

 **SIGAL** 

1

**Lider i
padiskutueshëm
në Shqipëri për
vitin 2024**

Përmbajtja

4

AVNI PONARI:

SIGAL, gjithmonë një hap përpara

8

SIGAL, MES TOP 100 KOMPANIVE NË SHQIPËRI

Renditja e revistës Monitor

11

SIGURIMET

Një Shtyllë Themelore e Zhvillimit Ekonomik

5

TREGU I SIGURIMEVE

SIGAL, lider i padiskutueshëm i tregut të sigurimeve në Shqipëri për vitin 2024

9

SEENEWS

SIGAL, mbetet kompania më e madhe shqiptare e sigurimeve në Evropën Juglindore

12

SIGAL PJESË E PIRAMIDËS

Ponari: Lokacioni më i ri i inovacionit në sigurime dhe edukimit financiar

6

SIGAL, MES TOP 100 KOMPANIVE NË SHQIPËRI

Renditja e revistës Monitor

10

PROBUSINESS

Ponari propozon zgjidhjen për pensionet: Sigurim i detyrueshëm me dy pjesë

13

SIGAL KOSOVA

“Tatimpaguesi i Vitit 2024”

15

PËRGJEGJËSI SOCIALE

SIGAL, **siguria** e suksesit tuaj.

Rrisni besueshmërinë
dhe ruani qëndrueshmërinë
financiare me një plan
sigurimi të përshtatur për
biznesin tuaj!

Çfarë mund të mbrohet?

- ✓ Pronë
- ✓ Përgjegjësi
- ✓ Garanci
- ✓ Makineri
- ✓ Automjetet
- ✓ Punonjësit

**Partneri juaj
në sigurime**



GJITHMONË NJË HAP PËRPARA

Viti 2024 ka shënuar një moment të rëndësishëm për SIGAL Group, duke konsoliduar pozitat e tij në treg dhe duke realizuar një seri suksesh përballë sfidave të ndryshme. Në këtë përmbyllje të vitit, theksoj me krenari arritjet dhe zhvillimet pozitive të kompanisë, e cila ka vazhduar të rritet dhe të adaptohet në një mjedis dinamik dhe sfidues ekonomikisht. Për vitin 2024, SIGAL Group ka arritur objektivat e tij kryesore, duke ofruar shërbime inovative për klientët dhe duke forcuar pozitat e tij në tregun e sigurimeve.

Megjithatë, suksesi i këtij viti nuk ishte vetëm rezultat i përpjekjeve të brendshme, por edhe reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimeve për klientët, duke i ofruar zgjidhje që janë në përputhje me standardet europiane dhe kërkesat e kohës. Por si çdo vit, edhe 2024 ka pasur sfidat e veta, dhe SIGAL Group ia ka dalë mbanë duke u përballur dhe duke i kthyer në mundësi rritjeje dhe zhvillimi. Teknologjia dhe inovacioni kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces, duke mundësuar përmirësimin e shërbimeve dhe operacioneve të brendshme. Duke u futur në vitin 2025, pritshmëritë janë të larta, duke pasur në fokus zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve më të avancuara, zgjerimin e shtrirjes për të qenë më pranë klientëve dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknologjike. SIGAL Group do të vazhdojë të mbetet një lider i besueshëm dhe një partner strategjik për individët dhe bizneset, duke synuar gjithmonë për të ofruar siguri dhe mundësi të qëndrueshme për të ardhmen.




CEO, SIGAL INSURANCE GROUP



Suksesi i këtij viti ishte rezultat i angazhimit të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimeve për klientët, duke i ofruar zgjidhje që janë në përputhje me standardet europiane dhe kërkesat e kohës.

SIGAL, LIDER I PADISKUTUESHËM I TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2024

Sipas raportit vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), SIGAL ka ruajtur pozicionin e saj si lider absolut në tregun shqiptar të sigurimeve, duke mbajtur një pjesë dominuese prej 27% të tregut për sigurimet e Jetës dhe Jo-Jetës për vitin 2024.



Avni Ponari

Shkrirja me “UNIQA”-n, ngjarja më e madhe për SIGAL

Kompania më e madhe e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria, festoi në mars 2024, 25-vjetorin e themelimit.

Në një koncert festiv në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, i ideuar në atë formë që të përfaqësonte të trija shtetet ku është prezent Grupi SIGAL UNIQA, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, qindra të ftuarit shijuan interpretimet magjike të tenorit me famë botërore Ramë Lahaj, sopranos Ulpiana Aliaj, këngëtares nga Maqedonia e Veriut Karolina Goçeva dhe Ansambllit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve.

Koncerti u moderua nga dyshja Ardit Gjebrea-Fjoralba Ponari, ndërsa nuk mungoi edhe shfaqja e një dokumentari ku u shfaq i gjithë rrugëtimi 25-vjeçar i SIGAL UNIQA-s.

Gjatë fjalës së tij përshëndetes, z.Avni Ponari, themelues dhe CEO i SIGAL UNIQA, bëri një rezymë të të gjithë ecurisë gjatë këtyre 25 viteve, idetë e para të themelimit, vështirësitë që kishte ky udhëtim në hapat e parë dhe arritjet gjatë këtij çerekshekulli

Sipas tij, ngjarja më e madhe në 25 vitet e SIGAL është padyshim shkrirja me kompaninë e njohur austriake “UNIQA Insurance Group”.





Foto gjatë mbremjes festive: nga e djathta Z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Grup dhe Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL Grup

“Ngjarja më e madhe në jetën 25 vjeçare të SIGAL, padyshim ka qenë shkrija me kompaninë e njohur austriake “UNIQA Insurance Group”. Gjigandi i sigurimeve evropiane ofroi të ishte partneri ynë duke i dhënë kompanisë tonë një dimension ndërkombëtar. Ne sot e themi me plot gojë se SIGAL është në Europë, jo vetëm për shërbimin por edhe për standartet evropiane që aplikon në çdo aspekt. Tashmë pozita lider është konsoliduar.

Klientët tanë kanë një siguri të pakrahasueshme për mbështetjen dhe garancitë që ofron SIGAL UNIQA. SIGAL u bë e para kompani shqiptare me partner ndërkombëtar duke garantuar tregun përmes investitorëve strategjikë, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”, tha gjatë fjalës së tij Ponari. I ftuar në event ishte edhe CEO i “UNIQA Insurance Group”, z.Andreas Brandstetter, i cili foli me superlativa për punën dhe arritjet e SIGAL UNIQA.



SIGAL, MES TOP 100 KOMPANIVE NË SHQIPËRI

E para në sigurime



SIGAL vazhdon të jetë jo vetëm kompania më e madhe dhe më e besuar e sigurimeve por edhe një mes Top 100 kompanive në Shqipëri.

Sipas rënditjes së revistës “Monitor” për Top 200 kompanitë më të mëdha në vend për vitin 2023, SIGAL renditet në vendin e 67-të, me një rritje prej 7 vendesh krahasuar me një vit më parë.

Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe teksa kompania e sigurimeve ofron produktet më novatore, është pranë klientëve kur ata kanë nevojë, respekton çdo kontratë konform ligjit, lidere në pagesat e drejtpërdrejta të dëmeve, ofertat e herëpashershme, mundësia që çdokush të sigurojë pronën, shëndetin apo automjetin pavarësisht të ardhurave që ka dhe të qenurit pjesë e shoqërive ku operon përmes nismave, aktiviteteve dhe sponsorizimeve të vazhdueshme.

Nga 8 kompani që operojnë në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në Shqipëri, mbetet në krye të tregut duke zotëruar rreth 30% të tij. Shifër kjo konstante që prej themelimit të saj. “SIGAL UNIQA Group Austria” u themelua në Tiranë në shkurtin e vitit 1999 dhe sot pas rreth 26 vjetësh është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ajo operon suksesshëm në të trija shtetet përmes 8 kompanive të saj, Jo-Jete, Jete, Risigurime dhe 1 Fond Pensioni Privat.

Rank	Company Name	Activity
67	SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA	Activity insurance (life & health)
68	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
69	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
70	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
71	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
72	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
73	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
74	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
75	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
76	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
77	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
78	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
79	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
80	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
81	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
82	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
83	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
84	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
85	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
86	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
87	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
88	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
89	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
90	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
91	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
92	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
93	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
94	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
95	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
96	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
97	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
98	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
99	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)
100	ALBA UNIQ	Activity insurance (life & health)

“SeeNews” publikon edicionin e rradhës “Top 100 Insurers”, e cila rëndit kompanitë më të mëdha të sigurimeve në rajonin e Evropës Juglindore.

Ndër të tjera, ajo që bie në sy është fakti se, SIGAL UNIQA Group Austria mbetet kompania shqiptare e sigurimeve në rajon.

Mes 100 kompanive, kompania e themeluar në Tiranë rënditet në vendin e 53-të.

Sipas “Seenews”, Top 100 kompanitë arritën gjatë vitit 2023 12.4 miliardë euro prime të shkruara, 10.6 miliardë euro më shumë se një vit më parë.

Ndërkohë, fitimi neto i kombinuar i siguresve

kryesorë të rajonit u ul me 1.9%, duke arritur në 622.1 milionë euro në 2023.

Në vitin 2022, fitimi neto i siguresve më të mëdhenj të Evropës Juglindore u rrit me 5.8%.

Siguresit sllovenë dhe rumunë vazhdojnë të dominojnë dhjetë vendet e para në renditje, secili me nga katër përfaqësues. Ndërsa Bullgaria ka më shumë kompani në mesin e 100 siguresve kryesorë, me plot 18 të tillë.

“SEE TOP 100” është një traditë e përvitshme që nga viti 2008, e cil paraqet kompanitë, bankat dhe siguresit më të mëdhenj në Evropën Juglindore.

“SEE TOP 100” SIGAL, mbetet kompania më e madhe shqiptare e sigurimeve në Evropën Juglindore

SEE top100 by SeeNews

SIGURIME ONLINE

 **SIGAL** 
UNIQA GROUP AUSTRIA

Duhet theksuar se, edhe dy filialet e grupit, në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, janë pjesë e TOP 100.

Ponari propozon zgjidhjen për pensionet: Sigurim i detyrueshëm me dy pjesë



Teksa pensioni shtetëror, për shkak edhe të krizës që ndodhet, nuk ofron të ardhura të mjaftueshme për përballimin e kostove të jetesës.

1 në 5 shqiptarë sot është i moshuar. Nga rreth 2.4 milionë qytetarë në total, më shumë se 473 mijë janë mbi 65 vjeç.

Ekspertët po shqyrtojnë opsione të ndryshme që mund të ndihmojnë skemën por edhe qytetarët që këta të fundit të kenë të ardhura të kënaqshme dhe të mjaftueshme në momentin që ndalojnë së punuari.

I ftuar në emisionin “Pro Business” në Klan Plus,


CEO i SIGAL UNIQA, Avni Ponari u shpreh se, kombinimi i pensionit shtetëror me atë që merr në privat bën që shuma të jetë e kënaqshme për pensionistët dhe ti përgjigjet kostove të jetesës.

AVNI PONARI: Shumë ndërmarrje dhe shumë individë, po afrohen me shumë shpejtësi dhe po krijojnë vlerat e tyre për pensionin dhe kjo është një garanci shumë e mirë sepse në qoftëse në shtet ti ke një pension 20 mijë lekë të reja dhe do marrësh 400 apo 500 në privat, pra pensioni yt shkon 700 mijë lekë (të vjetra) në total i gjithi së bashku.

Kështu që krijimi i kësaj incentive dhe krijimi këtij sistemi të tillë e bën të mundur që ti të marrësh një vlerë të caktuar. Shqipëria është nga të paktat vende që nuk e ka kolonën e dytë të investimeve. Që do të thotë, shteti përveç Sigurimeve Shoqërore që është 27% që paguhet nga paga, atëherë kjo 27 ndahet në 25 përsëmbull do ti çosh tek Sigurimet Shoqërore dhe 2% janë të detyrueshme ti çosh te një skemë e pensioneve private. Pra, ky është një stimulim shumë i madh, një mbështetje e madhe dhe një lehtësim i barrës së sistemit të Sigurimeve Shoqërore.

Skema aktuale ka mangësi. Dhe nga ajo që kam dëgjuar thuhet se nuk funksionon se në Shqipëri janë 700 mijë pensionistë që marrin pensionin dhe janë 700 mijë të punësuar. Pra raporti është 1 me 1. Në të gjithë botën është 4 punojnë dhe 1 merr pension. Ata kanë skemën e cila ndan sigurimin e detyrueshëm në dy pjesë, ku tek sigurimet vullnetare paguajnë 2%, pastaj qytetarët këtë 2% mund ta plotësojnë edhe me para të tjera për të marrë një pension më të lartë. Në Gjermani përsëmbull njerëzit investojnë në 2-3 fonde pensioni.

Sigurimet - Një Shtyllë Themelore e Zhvillimit Ekonomik



Industria e sigurimeve është njëra nga tre shtyllat e zhvillimit të ekonomisë së një vendi dhe veçanërisht e zhvillimit financiar të tij. Sa i pavarur është qytetari nga shteti dhe sa i mbrojtur është ai nga rreziqet e paparashikuara dhe legjislacioni në një vend, janë faktorë që ndikojnë në sigurinë e jetës së një popullsie që rritet në liri dhe pavarësi. Industria e sigurimeve është aq e madhe dhe aq e shtrirë sa përfshin çdo aspekt të jetës së qytetarëve të një vendi. Por çfarë mbulojnë sigurimet dhe nga çfarë rreziqesh e mbrojnë tregun? Themel i sigurimeve është sigurimi i përgjegjësishë, që nënkupton mbrojtjen nga rreziqet që vijnë nga furnizimi me energji elektrike, dëmet që mund të shkaktojë mjeku, avokati, kontabilisti,

estetisti, apo dëmet e shkaktuara nga komshinjtë, produktet ushqimore, interneti, zjarri, tërmeti, sëmundjet, dëmtimet për shkaqe të ndryshme si mallrat në transport, vjedhjet në shtëpi apo bizhuteri, shembjet e digave apo dherave, humbjet financiare për shkak të inflacionit apo humbjet e parave në banka, aksidentet ajrore, satelitët, bujqësia dhe blektorja, mbrojtja e produkteve në sasi dhe cilësi etj. Të gjitha këto janë raste të sigurueshme. Penetrimi në treg varet nga shumë faktorë. Për shembull, shqiptarët konsumojnë mesatarisht 50 euro në vit për produkte sigurimi, krahasuar me 6000 euro për një amerikan, 6000 franga për një zviceran dhe 3500 deri në 5000 euro për një europian. Në vendet fqinje, shifrat

variojnë nga 150 deri në 1500 euro. Pse ndodh kjo? Përgjigja qëndron te fakti se qeveritë e këtyre vendeve duan të mbajnë qytetarët të varur nga politika dhe të pasigurt për të ardhmen e tyre. Sot diskutohet kryesisht për sigurimet motorike, por disa individë nuk e kuptojnë rëndësinë e sigurimeve të tjera, duke menduar vetëm për sigurimet e makinave. Shqipëria ka një numër të lartë aksidentesh: rreth 300 të vdekur, mbi 100 të plagosur dhe mbi 30 mijë aksidente me dëme materiale çdo vit. Në aksidentet jashtë vendit, shqiptarët shpesh mbeten fajtorë, gjë që rrit ndjeshëm kostot e sigurimit. Asnjë vend në botë nuk e ka sigurimin e makinave vullnetar, për arsye të thjeshta ekonomike dhe sociale. Kjo rregullore e

re synon të ndëshkojë shkaktarët e aksidenteve dhe të favorizojë mjetet me kubikazh të vogël, duke rritur çmimet për ato me kubikazh të madh deri në 7%. Pyetja është e thjeshtë: A duhet të ketë ndryshime në sigurimet motorike dhe a duhet tregu të jetë më i vëmendshëm ndaj dëmeve dhe pagesave në kohë? Sigurisht që po. AMF është në një kërkesë të vazhdueshme për përmirësime dhe me siguri do të ketë ndryshime të tjera në të ardhmen. Çfarë duhet përmirësuar? Një legjislacion më i përmirësuar që rregullon më mirë marrëdhëniet mes të siguruarit dhe siguruesit, si dhe ndjekja më e kujdesshme e dëmeve në çdo aspekt.

SIGAL, pjesë e Piramidës




SIGAL një kompani sigurimi kaq novatore, që ecën me hapat e zhvillimit të teknologjisë, nuk mund të mos ishte pjesë e ndërtesës më novatore në Tiranë.

Falë bashkëpunimit me Fondin Amerikan të Zhvillimit, një partner i hershëm dhe shumë i rëndësishëm i SIGAL, dhe Bashkisë së Tiranës, një prej objekteve më të vizituara në kryeqytet, ka tashmë pjesë të mozaikut të saj të mirëideuar edhe kompaninë më të madhe të sigurimeve, “SIGAL”. Themeluesi dhe CEO-s i kompanisë, Avni Ponari, teksa foli mbi rëndësinë që kanë sigurimet në përditshmërinë e gjithësecilit prej nesh, u shpreh se, zyra e “SIGAL” pranë Piramidës së Tiranës nuk

do të jetë thjesht një zyrë ku klientët aktualë dhe të rinj do të marrin shërbime sipas standarteve evropiane por edhe një qendër inovacioni, rekreativiteti dhe auditor leksionesh mbi sigurimet dhe edukimin financiar në përgjithësi. “Është traditë e SIGAL-it që të jetë gjithmonë pranë gjërave të reja, pranë inovacioneve, pranë zhvillimeve dhe teknologjive. Zhvendosja e një zyre këtu në Qendër të Teknologjisë, mund ta quaj, të Tiranës, afër Piramidës, është një risi

për ne sepse me këtë ne përmbushim një detyrim që kemi ndaj stafit tonë dhe ndaj klientëve tanë. Këtu do të bëhen trajnime të fushave të ndryshme, aq më tepër trajnime për të rinjtë që duan të njohin botën e sigurimeve, një nga më të rëndësishmet në botën e qytetëruar. Për të qenë afër me ne dhe të jenë të punësuarit tanë. Por nga ana tjetër, ne kërkojmë që, në kuadër të dixhitalizimit dhe futjes së teknologjive të reja, ne t’ju shërbejmë klientëve edhe në pagesën e dëmeve në distancë”, u shpreh ndër të tjera Ponari.



“TATIMPAGUESI I VITIT 2024”

Tjetër vlerësim për SIGAL-in në Kosovë

Në një mbrëmje gala, traditë tashmë në Kosovë, organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, “THE BEST OF KOSOVO 2024”, u ndanë çmimet për bizneset dhe sipërmarrjet më të suksesshme në vend.

SIGAL Kosova është vlerësuar me çmimin “Tatimpaguesi i Vitit 2024”, vlerësim që e merr pej disa vitesh rradhazi.

“Në mbrëmjen prestigjioze të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, SIGAL, kompania lider e sigurimeve në Kosovë, është vlerësuar edhe një herë me çmimin “Tatimpaguesi i Vitit 2024”.

Ky vlerësim vjen si një dëshmi e përkushtimit dhe angazhimit tonë të vazhdueshëm ndaj çdo klienti dhe përgjegjësie që kemi si kompani.

Marrja e këtij çmimi për disa herë rradhazi vetëm sa forcon vendosmërinë tonë për të përmirësuar shërbimet tona dhe për të vazhduar të kemi një ndikim pozitiv.

Ne jemi thellësisht të nderuar nga kjo njohje dhe mbetemi plotësisht të përkushtuar që të shërbejmë me profesionalizëm, duke ruajtur vlerat tona dhe duke kontribuar në rritjen e ekonomisë së Kosovës“, shkruan kompania në rrjetet sociale.

Në 21 vite të ekzistencës së saj në tregun e sigurimeve në Kosovë, SIGAL është jo vetëm kompania më e besuar e sigurimeve por edhe paguesi më i madh i dëmeve, në një vlerë prej rreth 100 milionë eurosh në vite.

SIGAL Kosova është gjithashtu një kontribues i rëndësishëm i jetës sociale në vend, me fokus të veçantë shëndetësinë,

edukimin, sportin, artin dhe kulturën.

– Sponsor Gjeneral i Klubit të Basketbollit “SIGAL Prishtina”, i Federatës së Futbollit të Kosovës, Federatës së Basketbollit të Kosovës, i Superligës së Femrave në futbollin dhe shumë e shumë aktiviteteve të tjera.



“JETË PLUS”

ME SHPËRBLIM TË MENJËHERSHËM

- ✓ Pagesë e menjëhershme në varësi të shumës së siguruar
- ✓ Shuma e siguruar nga 5,000 euro, 10,000 euro, 15,000 euro, 20,000 euro, 30,000 euro
- ✓ Opinioni i dytë mjekësor nga spitalet më të specializuara në botë
- ✓ Për moshë nga 0 - 80 vjeç

DUKE FILLUAR
30€
NË VIT/
PERSON



PËRGJEGJËSI SOCIALE EKZAMINIME FALAS NË DIVJAKË



KLINIKA LËVIZËSE “SIGAL VITAL TRUCK”, DY DITË VIZITA DHE EKZAMINIME FALAS NË DIVJAKË

Klinika Lëvizëse “SIGAL Vital Truck” ka mbyllur një tjetër rrugëtim të suksesshëm shërbimi mjekësor FALAS, këtë herë në qytetin e Divjakës.



Në datat 19 dhe 20 Prill “SIGAL Vital Truck” u stacionua në qendër të qytetit të Divjakës ku stafi profesional i saj ofroi shërbime falas për banorët e zonës.



Ky aktivitet është pjesë e politikave dhe vizionit të kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri në drejtim të mirëqenies së klientëve të saj dhe sensibilizimit të qytetar për kujdes të vazhdueshëm për shëndetin.

ÇFARË SHËRBIMESH OFRON “SIGAL VITAL TRUCK”?

Vizitë dhe konsultë me mjek të përgjithshëm

Vizitë dhe konsultë me mjek specialist

Vlerësim dhe ekzaminim i gjëndjes së përgjithshme: BMI-peshë-gjatësi,

Matje e nivelit të sheqerit në gjak,

Matje e oksigjenit në gjak

Vizitë e syve dhe veshit për probleme akute/infeksione, etj.,

Elektrokardiograma e zezës, matje e tensionit dhe e frekuencës së zezës

Echo abdominale,

Matje e kapacitetit vital të mushkërive, spirometry Etj.



Prej vitit 2015, kur edhe u ndërtua, “SIGAL Vital Truck” ka bërë mbi 4500 km, duke u ndalur në 200 vendqëndrime, ndërsa në vazhdim do të jetë edhe në zona të tjera të vendit.

Kampionët me kampionët/ Vijon bashkëpunimi KB Prishtina-SIGAL UNIQA



Klubi i Basketbollit Prishtina dhe kompania e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group Austria vazhdojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Kryetari i klubit Blerand Stavileci tha gjatë konferencës për media se, bashkëpunimi me SIGAL UNIQA e ka ndihmuar Prishtinën që ta vazhdoj rrugën e sukseseve dhe fitimin e trofeve të shumtë.

Ai shtoi se për 21 vjet bashkëpunim këto dy brende kanë qenë shembull i bashkëpunimit edhe për klubet tjera në Kosovë, ndërsa shtoi se CEO i SIGAL UNIQA, Avni Ponari ka qenë gjithmonë afër klubit duke e mbështetur atë në situata të mira por edhe të vështira.

Nga ana tjetër, Avni Ponari theksoi se këto dy brende janë rritur duke shënuar suksese të përbashkëta dhe duke arritur trofe të shumtë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Ai shtoi se ndihet krenar me bashkëpunimin e KB Prishtinën gjatë gjithë këtyre viteve dhe është i lumtur që do të vazhdojë ta mbështesë këtë klub.

SIGAL, GJITHMONË PRANË SPORTIT

SIGAL ka qenë gjithmonë një ogur i mirë për sportin dhe sportistët. Në SIGAL besojnë fort se Sporti është mjeti më efikas i edukimit, i argëtimit, i parandalimit të sëmundjeve, dhe forcimit të marrëdhënieve sociale.



SIGAL partneri besnik i FSHF.



Ndërtoni një karrierë të suksesshme

Federata Shqiptare e Futbollit dhe SIGAL zhvilluan një takim informues në “Shtëpinë e Futbollit” me përfaqësues të klubeve të Kategorisë Superiore në prag të fillimit të sezonit të ri futbollistik 2024/2025. Fokusi i diskutimeve ishte përditësimi i politikave të sigurimit të lojtarëve të Kategorisë Superiore dhe protokollet që ndiqen në rastet e dëmtimeve të lojtarëve. SIGAL prezantoi disa paketa të sigurimit për klubet, që përfshijnë lojtarët e akademive, të

cilët mund të aktivizohen edhe me ekipin e parë dhe mund të përfitojnë nga rimbursimi në rast dëmtimi.

Federata Shqiptare e Futbollit dhe SIGAL UNIQA Group Austria kanë një bashkëpunim të suksesshëm që prej vitit 2016-të. SIGAL UNIQA Group Austria është një ndër sponsorët kryesorë të FSHF-së dhe Kombëtares së futbollit teksa kontributi dhe mbështetja gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë e madhe.

Si sportistë

profesionistë, por edhe nëse jeni sportistë amator, ju do të keni nevojë për sigurimin nga dëmtimet apo aksidentet që mund të ndodhin.

Përfitimet:

- Garanci financiare për sportistin për shpenzime mjekësore nga aksidenti
- Vlerë për punëdhënësin që siguron sportistët
- Garanci për ekipin që detyrimet që mund ti lindin i paguan siguruesi



SIGAL gjithmonë pranë komuniketit

Punonjësit e SIGAL, fushatë pastrimi në Plazhe

Punonjësit e SIGAL vazhdojnë traditën e përvitshme në pastrimin e plazheve në vend.

Pas ditë pas Ditës Botërore të Mjedisit dhe në vigjilje të fluksit turistik, punonjësit e dy degëve të kompanisë në Shkodër ishin sot në plazhin e Velipojës ku për orë me rradhë pastruan zonat më problematike.



Orkestra e Harqeve "SIGAL" merr duartrokitjet e të pranishmëve

Marrja në sigurim dhe pagimi i dëmeve është detyrë për çdo kompani sigurimi. Por të jesh pranë komunitetit përmes sponsorizimeve të shumta në art, kulturë, sport etj shumë pak kompani e bëjnë. Dhe një prej tyre është padyshim SIGAL, e cila ka mbështetur gjatë gjithë kohës evente ku më i fundit ishte koncerti pranë bregdetit të Adriatikut. Orkestra e Harqeve "SIGAL" performoi në një takim biznesmenësh të rangut të lartë.





“MALET E GJIGANDËVE”/ PROMOVHET NË TIRANË STUDIMI HISTORIK DEDIKUAR GEGËVE

Me mbështetjen e veçantë të CEO-s së “SIGAL”, Avni Ponari, u promovua sot në Tiranë libri “Malet e Gjigandëve”. I shqipëruar nga diplomati Mal Berisha, kjo vepër është një studim mbi gegët e maleve veriore të Shqipërisë, i kryer nga Carleton S. Cooni nga Universiteti i Harvardit, në vitet 1929-30, në veri të vendit.

Kosovë Së bashku për Shëndet...Edukim, Mbështetje dhe Ndërgjegjësim

Tetori rozë është muaji i guximit, ndërgjegjësimit dhe ndryshimit!

Pavarësisht nga mosha, gjinia, ngjyra, kontinenti apo statusi social, ne të gjithë përballemi me një armik të përbashkët: kancerin.



Maqedoni e Veriut Në mbështetje të garës së grave “Avicena 2024”

Në frymën e sportit, pjesë e ekipit të femrave të UNIQA AD Skopje, nën sloganin "Jetojmë më mirë së bashku" u bashkuan dhe mbështetën garën e grave #Avicena 2024.

Edhe një herë, ne theksojmë rëndësinë e një kompanie në transmetimin e zakoneve pozitive në shoqëri, si dhe rëndësinë e inkurajimit dhe motivimit të ekipit në zakone të shëndetshme të jetesës.



Për herë të parë në Shqipëri/

SIGAL sjell FULLKASKO +AutoSOS në opsionin ditor



Doni që çdo udhëtim i juaji brenda Shqipërisë të jetë i sigurtë në çdo sekondë?

Mos u shqetësoni! SIGAL di të japë gjithmonë zgjidhjet perfekte.

Kompania lider e sigurimeve në Shqipëri, e njohur për risitë dhe inovacionet që sjell vazhdimisht, ofron tashmë një super-mundësi edhe për ata që zgjedhin të udhëtojnë jo me automjetet e tyre.

Cilido që merr një makinë me qira përmes aplikacionit “RentOut” dhe do të shijojë udhëtimin pa u shqetësuar për të papriturat e rrugës,

SIGAL mundëson policën e sigurimit Full KASKO dhe shërbimin e Asistencës Rrugore “AutoSOS” edhe me opsion ditor.

Me pak fjalë, për aq kohë sa ti përdor makinën e marrë me qira, aq edhe do të paguash për sigurimin e plotë të saj.

Çfarë mbulin Sigurimi Full KASKO?

- Dëmtimet aksidentale
- Thyerja e xhamave
- Zjarr, rrufe, eksplozion
- Katastrofa natyrore
- Dëmtim në parkim nga një mjet tjetër

Çfarë ofron Asistenca Rrugore “SIGAL AutoSOS”?

- Qendër suporti 24 orë të ditës, 7 ditë të javës
- Riparim në vend i automjetit
- Shërbimi karroatreci
- Zëvendësim mjeti
- Transport Alternativ

Shijoni çdo udhëtim tuajin me SIGAL dhe “Rentout”, pa u shqetësuar se çfarë surprizash mund tu sjellë rruga

Sharkoni tani aplikacionin në rentout.ai



BI ONLINE SIGURACIONIN

Vetëm me disa klikime blini nga celulari juaj sigurimet e:

- Makinës
- Shtëpisë
- Shëndetit



SIGAL FpcHEALTH

Apliko Online për rimbursim të shpenzimeve shëndetësore

- Klientët me kartë shëndeti SIGAL
- Ndiq në kohë reale statusin e Kërkesës
- Karta elektronike
- Akrivë e dokumentave mjekësor



Mbrojtja e shtëpisë është **investimi** më i sigurt

- ✓ Mbrojtje nga zjarri dhe ngjarje natyrore
- ✓ Sigurimi i ndërtesës dhe pajisjeve
- ✓ Sigurimi i përgjegjësive ndaj të tretëve

Sigurimi i
shtëpisë
fillon nga
5,000
lekë/vit

